



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 117 /2026
Datë: 15/06/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 10 dhe 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrija e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e Projekt Rregullores ZKM - Nr. __/2026 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores ZKM-Nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, në këtë përbërje:

- 1.1. Ridvan Hoti, SP/MD, Kryesues;
- 1.2. Dhurata Gutaj, Kabineti i ministres/MD, Zv. kryesuese;
- 1.3. Lulzim Beqiri, DL/MD, anëtar;
- 1.4. Bahri Beqiri, DShP/MD, anëtar;
- 1.5. Nexhat Sylja, DBF/MD, anëtar;
- 1.6. Arta Nuredini, DBNj/MD, anëtare;
- 1.7. Rinor Gjergji, DL/MD, anëtar;
- 1.8. Brikena Rrahmani, DQDDTMVK/MD, anëtare.

3. Gjatë hartimit të Projekt Rregullores, Grupi Punues duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren (QRK) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit përkatës në fuqi për hartimin e legjislacionit.

4. Sipas nevojave të Grupit Punues për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe zyrtarë të tjerë të njësive organizative të Ministrisë së Drejtësisë,.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë



Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*